



Bulevardi "Gjergj Fishta", Kompleksi "Tirana 2000", Kulla 4, Tiranë
Tel: +35542251475; E-mail: info@acpd.org.al
Website <https://www.acpd.org.al>

Thirrje për Koordinator projekt "Njësitë e qeverisjes vendore krijojnë një mjedis të favorshëm që të rinjtë të realizojnë potencialin e tyre, duke u fokusuar në ofrimin e shërbimeve dhe arritjen e vajzave dhe djemve adoleshentë në zonat e varfëra/rurale"

Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin është një organizatë jo-fitimprurëse, e cila prej vitit 1996 punon në fushën e Shëndetit Seksual dhe Riprodhues, Popullsisë dhe Zhvillimit. Në kuadër të Programit: "**Bashkimi Evropian për Barazinë Gjinore në Shqipëri 2021-2022**", mundësuar nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA) me mbështetjen Financiare të Bashkimit Evropian (BE) QSHPZH dhe disa organizata të tjera të Shoqërisë Civile po zbatojnë projektin "Njësitë e qeverisjes vendore krijojnë një mjedis të favorshëm që të rinjtë të realizojnë potencialin e tyre, duke u fokusuar në ofrimin e shërbimeve dhe arritjen e vajzave dhe djemve adoleshente në zonat e varfëra/rurale".

Qëllimi i projektit që po zbatohet nga QSHPZH është: *Njësitë e qeverisjes vendore krijojnë një mjedis të favorshëm për të rinjtë që të realizojnë potencialin e tyre, duke u fokusuar në ofrimin e shërbimeve dhe arritjen e vajzave dhe djemve adoleshentë në zonat e varfëra/rurale.*

Vajzat dhe djemtë adoleshentë janë faktorë thelbësor në formimin e barazisë midis grave dhe burrave të brezit të ardhshëm të të rriturve në Shqipëri. Megjithatë, informacioni mbi realitetet dhe nevojat specifike gjinore të vajzave dhe djemve adoleshentë që jetojnë në Njësitë Administrative të vendit dhe veçanërisht në zonat e varfëra dhe rurale është i pakët.

Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin do të ndihmojë për të adresuar këto çështje, në bashkëpunim me komunitetet e njësisë administrative **Shirgjan të bashkisë Elbasan** (fshtrat: Shirgjan, Bathes, Bujqes, Jagodinë, Kuqan, Kryezjarr) dhe komunitetet e njësisë administrative **Velipojë të bashkisë Shkodër** (fshtrat: Velipojë, Pulaj, Luarzë, Baks-Rrjoll, Gomsiqe, Baks i Ri, Pulaj, Reç i Ri, Ças, Mali Kolaj) dhe njësitë e tyre të qeverisjes vendore duke ndërmarrë veprime konkrete:

- Do të ofrojë sesione të dedikuara të zhvillimit/fuqizimit pozitiv të të rinjve me ndjeshmëri gjinore dhe aftësive jetësore për vajzat dhe djemtë adoleshente.
- Do të mobilizojë të rinjtë vendas për të zhvilluar sesione konsultimi publik mbi zhvillimin e të rinjve me ndjeshmëri ndaj barazisë gjinore dhe arritjen e të rinjve me platforma dhe nisma rinore, me përfaqësues të pushtetit vendor, shkolla, profesionistë, shoqëri civile dhe grupe të të drejtave të grave;
- Do të ofrojë mbështetje teknike, trajnime dhe udhëzime për stafin e Njësive të Qeverisjes Vendore për përfshirjen e qasjes së zhvillimit të të rinjve të përgjegjshëm ndaj komponentit gjinor dhe qasjes me qendër të rinjtë në planet e zhvillimit lokal (p.sh. Planet Sociale, Planet e Zhvillimit Ekonomik Lokal, Planet Lokale të Veprimit dhe ato të ngjashme);
- Do të për përgatisë dhe lançojë një Dokument të/Politikave/Avokimit mbi shtrirjen dhe shërbimet gjithëpërfshirëse, të ndjeshme ndaj gjinisë me në qendër të rinjtë në nivel të njësive të qeverisjes vendore (duke përfshirë zonat rurale/Njësitë Administrative);

- Do të shkëmbejë përvojën dhe praktikën më të mira për zhvillimin pozitiv të të rinjve me ndjeshmëri gjinore dhe shtrirjen në zonat rurale me palët kryesore të interesuara, duke përfshirë nismat në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Për koordinimin e këtij projekti në vitin 2021 QSHPZH kërkon të kontraktojë dy koordinatorë lokal – Shkodër dhe Elbasan.

1- **Koordinatorët e projektit respektivisht në Shkodër dhe Elbasan do të jenë përgjegjës për:**

- a) Koordinimin e punës së projektit
- b) Monitorimin dhe sigurimin e mbështetjes së zbatimit të projektit në zonat e përfshira në projekt **në Bashkinë Shkodër në Njësinë Administrative Velipojë në fshatrat:** Velipojë, Pulaj, Luarzë, Baks-Rrjoll, Gomsiqe, Baks i Ri, Pulaj, Reç i Ri, Ças, Mali Kolaj **dhe në Bashkinë Elbasan në Njësinë Administrative Shirgjan:** Shirgjan, Bathes, Bujqes, Jagodine, Kuqan, Kryezjar

I. DETYRAT KRYESORE

Të zbatojë aktivitetet e përfshira në projekt, duke përfshirë edhe asistencën teknike dhe logjistikën për të gjitha aktivitetet:

- 1- Pesë takime prezantuese me aktorët kryesorë vendorë duke përfshirë Bashkinë, Njësitë e Kujdesit Vendor Shëndetësor, Drejtoritë e Arsimit, Policinë, Organizatat me Bazë Komuniteti, përfaqësuesit fetarë, të rinjtë nga njësitë administrative e përzgjedhura etj.
- 2- Koordinimi i Vlerësimit në njësitë administrative të përzgjedhura të bashkisë Elbasan dhe të bashkisë Shkodër lidhur me qasjen e të rinjve në zonat rurale, të moshës 15-30 vjeç në shërbime, dhe informacione lidhur me barazinë gjinore, shëndetin seksual dhe riprodhues; përvojat e tyre në këtë drejtim. Vlerësimi gjithashtu do të zhvillohet edhe me 10 përfaqësues të pushtetit vendor, të institucioneve publike, shoqërisë civile me qëllimin që të identifikojë programet/planet lokale ekzistuese të zhvillimit për fuqizimin e të rinjve, me ndjeshmëri ndaj gjinisë dhe nevojën për t'i hartuar/përmirësuar këto plane (shtator-mesi i nëntorit)- në bashkëpunim me ekspertin kërkimor dhe lehtësuesit vendor.
 - Zhvillimi i një metodologjie studimi dhe pyetësorit (tre lloje pyetësorësh - një për të rinjtë dhe një tjetër për palët kryesore të interesuara).
- 3- Harta e shpërndarjes së pyetësorit në koordinim me stafin e projektit të QSHPZH-së dhe palët e interesuara lokale. 90 pyetësorë me të rinj dhe 10 me aktorë kryesorë.
- 4- Trajnim gjysëm ditor me grupin e punës për vlerësimin e nevojave (Shkodër & Elbasan)
 - Të bashkëpunojë me manaxherin e projektit dhe të projektit të BE/UNFPA-së, stafin e financës për të zbatuar aktivitetet dhe disbursuar buxhetet përkatëse në kohë me aprovimin e drejtorit ekzekutiv.
 - Të sigurojë dokumentimin e të gjithë aktivitetëve të projekteve duke i rakorduar me shpenzimet e buxhetit.
 - Të krijojë lidhje me partnerët që veprojnë në fushën e Barzisë Gjinore të Drejtave të Vajzave dhe Grave dhe Shëndetit Seksual dhe Riprodhues.
 - Të përgatisë raportin përfundimtar të projektit në gjuhën shqipe dhe angleze sipas kërkesave të manaxherit të projektit.

II. AFTËSI

Aftësi analitike; të shkruajë raporte; administrative dhe organizuese; njohuri të mira kompjuterike; aftësi lehtësuese/trainuese; rrjedhshmëri në Anglisht. Aftësi të shkëlqyera ndërpersonale dhe komunikuese si edhe përkushtimi ndaj pjesëmarrjes së të rinjve është kusht. I aftë për të artikuluar qartë në konferenca dhe takime.

III. ARSIMI DHE KUALIFIKIMET E KËRKUARA

- Të ketë diplomë universitare
- Të dijë mirë gjuhën angleze me gojë dhe me shkrim
- Të dijë mirë përdorimin e kompjuterit në programet bazë të tij.
- Trainimet në shëndetin riprodhues dhe përgatitjen e menaxhimin e projekteve përbëjnë prioritet.

IV. AFTËSI PERSONALE

Përkushtim ndaj çështjeve të të drejtave të njeriut, specifiku për të drejtat e shëndetit seksual dhe riprodhues të të rinjve; mendje hapur ndaj ideve dhe njerëzve; i aftë të punojë në një ambient multikultural; i gatshëm për të udhëtuar në udhëtuar në terren mbi bazën e projekteve; i aftë të punojë nën presion dhe për të arritur afatet; me inisiativë; fleksibël dhe i aftë për të punuar në skuadër.

Pagesa 888\$ (3 muaj)

Ofruesi i shërbimit është i detyruar që nga shuma e marrë të paguajë 15% vlerën e tatimit në burim mbi të ardhura në favor të shtetit shqiptar, ose të sjellë fature tatimore të njohur nga ligji Shqiptar për këto shërbime të ofruara.

2- Konsulent për Vlerësimin e nevojave për hartim/përmirësim të planeve zhvillimore për të rinjtë të bazuara në ndjeshmëri gjinore dhe ofrimin të shërbimeve përkatëse si edhe qasjen e të rinjve në shërbime sociale dhe ato të shëndetit seksual dhe riprodhues

QSHPZH po kërkon një konsulent për të zhvilluar një metodologji kërkimi lidhur hartimin/përmirësimin e planeve zhvillimore të bazuara në ndjeshmëri gjinore dhe ofrimin të shërbimeve përkatëse si edhe qasjen e të rinjve në shërbime sociale dhe ato të shëndetit seksual dhe riprodhues në Bashkinë Shkodër në Njësinë Administrative Velipojë në fshatrat: Velipojë, Pulaj, Luarzë, Baks-Rrjoll, Gomsiqe, Baks i Ri, Pulaj, Reç i Ri, Ças, Mali Kola j dhe në Bashkinë Elbasan në Njësinë Administrative Shirgjan: Shirgjan, Bathes, Bujqes, Jagodine, Kuqan, Kryezjar

Vlerësimi në njësitë administrative të përzgjedhura të bashkisë Elbasan dhe të bashkisë Shkodër do të ketë qëllim të hulumtojë:

- 1) Qasjen e të rinjve në zonat rurale, të moshës 15-30 vjec në shërbime, dhe informacione lidhur me barazinë gjinore, shëndetin seksual dhe riprodhues; përvojat e tyre në këtë drejtim.
- 2) Vlerësimi gjithashtu do të zhvillohet edhe me përfaqësues të pushtetit vendor, të institucioneve publike, shoqërisë civile me qëllimin që të identifikojë programet/planet lokale ekzistuese të zhvillimit për fuqizimin e të rinjve, me ndjeshmëri ndaj gjinisë dhe nevojën për t'i

DETYRAT KRYESORE

Zhvillimi i metodologjisë së studimit do të realizohet në 5 ditë pune duke përfshirë:

- 1- Tre tipe pyetësori—a) një për djemtë e moshës 15-30 vjec dhe b) një pyetësor për vajzat e moshës 15-30 vjece c) dhe një tjetër për aktorët lokal të projektit;
- 2- Hartimi i një baze të dhënash për hedhjen e të dhënave;
- 3- Përmbledhja e të dhënave dhe analizimi i tyre;
- 4- Raporti përfundimtar

MARRËDHËNIET KRYESORE

Me mbështetjen e manaxheri të projektit konsulenti do të:

- Kërkojë komente dhe të dhëna nga partnerët e projektit dhe nga një pjesë e të rinjve të përzgjedhur në fazat vendimtare si gjatë zhvillimit të pyetjeve të detajuara të kërkimit, metodologjisë, mjeteve dhe gjatë draftimit të gjetjeve;
- Të lidhet me partnerët e projektit përmes pikës fokale të projektit si menaxherit të projektit, gjatë zbatimit e hulumtimit.
- T'u ofrojë partnerëve të projektit udhëzime të qarta për mbledhjen e të dhënave, rishikimin e të dhënave lokale dhe raportimin e tyre te konsulenti.
- Konsulenti pritet të monitorojë partnerët gjatë mbledhjes së të dhënave lokale në kohë si edhe raportimin tek konsulenti.

AFATI KOHOR DHE AKTIVITETET KRYESORE TË KONSULENCËS

Kjo konsulencë do të menaxhohet në bazë të rezultateve duke filluar sa më shpejt të jetë e mundur.

- Draft koncepti për metodologjinë dhe procesin të prezantohet—(Java e I e nëntorit 2021);
- Finalizimi i metodologjisë dhe mjeteve deri më – (Java I nëntorit 2021);
- Kërkim koordinimi/zbatimi (Java II- III e nëntorit)
- Analiza dhe zhvillimi i raportit të kërkimit (afati i fundit Java e IV e nëntorit dhe java I e dhjetorit)
- Prezantimi i gjetjeve e hulumtimit tek partnerët e projektit (afati i fundit 31 dhjetor 2021)

REZULTATET

- Metodologjia dhe procesi i kërkimit
- Raporti i plotë i analizës duke përfshirë p.sh.: 1. Një përmbledhje ekzekutive 2. Metodologji 3. Analizë e përgjithshme e zonave të përgjedhura dhe Shqipërisë në tërësi 4. Kapitujt e studimit 5. Përfundimi dhe rekomandimet
- Konsulenti është përgjegjës për redaktimin dhe kontrollin e cilësisë së raportit në gjuhën angleze

Pagesa e ekspertit 2959 \$

Ofruesi i shërbimit është i detyruar që nga shuma e marrë të paguajë 15% vlerën e tatimit në burim mbi të ardhura në favor të shtetit shqiptar, ose të sjellë fature tatimore të njohur nga ligji Shqiptar për këto shërbime të ofruara.

SPECIFIKIMET E KONSULENTIT

E detyrueshme

- Diplomë akademike/përvojë e dëshmuar në zhvillimin dhe kryerjen e kërkimit cilësor
- Njohuri të shkëlqyera të gjuhës angleze

Aseti

- Njohuri të forta në fushën e shëndetit publik, shëndetit seksual dhe riprodhues dhe barazisë gjinor
- Përvojë pune me të rinjtë

3. Administrator pyetwori

Ofrimi i shërbimit “Administrimi i pyetësorit në njësitë administrative të përzgjedhura (përfshirë fshatrat) Në Bashkinë Elbasan në Njësinë Administrative Shirgjan: Shirgjan, Bathes, Bujqes, Jagodine, Kuqan, Kryezjar” në kuadër të projektit “Njësitë e qeverisjes vendore krijojnë një mjedis të favorshëm që të rinjtë që të realizojnë potencialin e tyre, duke u fokusuar në ofrimin e shërbimeve dhe arritjen e vajzave dhe djemve adoleshente në zonat e varfëra/rurale- EU4GENDER sipas Planit të punës që po zbaton Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin, me mbështetjen e UNFPA për vitin 2021.

DETYRAT KRYESORE

- Administrimin i pyetësorit në koordinim me stafin e projektit të QSHPZH-së, koordinatorin lokal dhe palët e interesuara lokale. 90 pyetësorë me të rinj dhe 10 me aktorë kryesorë në njësitë e përzgjedhura.
- Të marrë pjesë në trajnimin për administrimin e pyetësorit organizuar nga koordinatori lokal.
- Të prezantojë pyetësorin tek partnerët duke përcjellë qartë qëllimin dhe ruajtjen e të dhënave të personave që do të përfshihen në pyetësor.
- Të hartojë hartën e shpërndarjes së bashku me koordinatorin lokal.
- Të bashkëpunojë me koordinatorin lokal dhe manaxherin e projektit për administrimin e pyetësorit.
- Të sigurohet që plotësimi i pyetësorëve kryhet në mënyrë të plotë dhe me cilësi nga djemtë, vajzat dhe aktorët kyc.
- Të mbledhë të gjithë pyetësorët dhe t'i hedhë në bazën e të dhënave të krijuar nga eksperti.
- Të komunikojë me ekspertin e hartimit të hulumtimit për të ofruar informacion dhe input për cdo paqartësi.

AFATI KOHOR

Java II e nëntorit—java III e nëntorit.

SPECIFIKIMET E ADMINISTRATORIT TË PYETËSORIT

- Përvojë e dëshmuar në administrimin e pyetësorëve; pjesëmarrje në studime të mëparshme

Aseti

- Njohuri në fushën e shëndetit publik, shëndetit seksual dhe riprodhues dhe barazisë gjinor
- Përvojë pune me të rinjtë

Pagesa: 493 \$

Ofruesi i shërbimit është i detyruar që nga shuma e marrë të paguajë 15% vlerën e tatimit në burim mbi të ardhura në favor të shtetit shqiptar, ose të sjellë fature tatimore të njohur nga ligji Shqiptar për këto shërbime të ofruara.

Ju lutem dërgoni në adresën e emailit bhylviu@acpd.org.al ose info@acpd.org.al, ose fizikisht pranë zyrave të QSHPZH-së një CV dhe një dokument identiteti brenda datës 7 shtator.